

PKR.nr.214/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët profesionistë Suzana Çerkini kryetare, Afërdita Bytqi dhe Arben Hoti anëtarë, në çështjen penale kundër të akuzuarit V. G. nga P., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Marrje rryshfeti nga neni 343 par. 2 lidhur me nenin 23 te KPK, i akuzuar sipas Propozim Akuzës së Prokurorisë Komunale, tani Themelore, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.3958/2012 të datës 30.07.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me data 25.03.2016, 13.04.2016, 21.07.2016, 13.10.2016, 17.10.2016, në prani të prokurorit të shtetit Feti Tunizliu dhe të akuzuarit V. G., me mbrojtësin sipas autorizimit, av.G. H., me datë 19.10.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari V. G., nga i ati Rr. dhe nëna R., e vajzërisë T., i lindur me datë *data e lindjes...*, në P., lagja V., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i i dentifikuar me LNJ të RKS me numër personale *numer personal...*,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 18.06.2012 rreth orës 20.30, në mengjistarlen Prishtinë-Pejë në fshatin Sllatinë, në poziten e pjesëtarit të Policisë së Kosovës, Njësia e Trafikut Rajonal-Patrolla, në bashkëveprim me të pandehurin H. K., kanë kërkuar në emër të rryshfetit para në shumë prej 300 euro, kurse kanë marrë rryshfet para në shumë prej 100 euro nga i dëmtuari F. H., me ç'rast të njëjtit nuk i kanë shqiptuar fletëparaqitje për kundërvajtje të shkaktuar në komunikacion,

- me këtë ka kryer veprën penale në bashkëkryerje Marrje rryshfeti nga neni 343 par. 2 lidhur me nenin 23 te KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11,15,23,34,41,42,43,45,64 të KPK dhe neneve 327, 357, 359, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i cakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1 (një)** viti i cili denim nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy) vjetësh** nuk do të kryejë vepër të re penale,

Obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Prishtinë, tani Themelore, Departamenti për Krime të Rënda, me Propozim Akuzën PP.nr.3958/2012 të datës 30.07.2013, ka akuzuar V. G.n dhe H. K.n për vepër penale në bashkëkryerje Marrje rryshfeti nga neni 343 par. 2 lidhur me nenin 23 te KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas adminsitrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, duke vepruar sipas propozim akuzës së lartshënuar, me datë 25.06.2016 ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, për të vazhduar mëtej me procedimin e çështjes, mirëpo për shkak të mungesës së t'akuzuarit H. K. dhe, pas konstatimit zyrtar të policisë të datës 22.07.2014, se H. K. jeton në Francë, në senancën e datës 10.10.2014 duke qenë se i njëjti është bërë i paarritshëm për gjykatën, me aktvendim ka vendosur për veçimin e procedurës ndaj të akuzuarit H. K. dhe njëherësh ka vazhduar procedurën ndaj të akuzuarit V. G..

Procedimi i kësaj çështjeje penale, për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues, me datë 25.03.2016 është rifilluar rishtaz dhe, gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari V. G. ka mohuar fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa prokurori i shtetit ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, dhe propozimit që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Meqenëse i akuzuari V. G. ka mohuar fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, gjykata ka vazhduar procedimin e çështjes, me administrimin e provave materiale të propozuara.

Gjykata, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, komform nenit 361 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike e ka vërtetuar nga provat që janë proceduar gjatë senacave të shqyrtimit gjyqësor, dhe atë duke filluar nga dëshmia e të dëmtuarit të dhëne në cilësinë e dëshmitarit F. H., dëshmia e dëshmitareve A. S., K. G. dhe, si dhe nga leximi i provave materiale të propozuara në aktakuzë, të shënuara si në vijim: Orari ditor i patrullave i datës 18.06.2012, Videoincizimi i CD-

së, fotokopja e monedhës në vlerë prej 100 euro me nr.serik S23754944905, (ndërsa sa i përket Vendimit mbi suspendimin me pagesë të datës 18.06.2012, të propozuar nga prokuroria, dhe mirënjohjes-medalje për shërbim me besnikëri të vitit 2010 të propozuar nga mbrojtja, gjykata të njëjtat nuk i ka vlerësuar si prova relevante që sjellin ndonjë të dhënë të rëndësishme në funksion të ndriçimit të kësaj çështje penale juridike).

Nga dëshmia e të dëmtuarit, dhënë në cilësinë e dëshmitarit, F. H., vërtetohet fakti se në ditën kritike i njëjti ka qenë duke udhëtuar në rrugën në drejtim të Komoranit, kur është ndaluar nga dy policë, me arsyen e vozitjes së shpejtë dhe, me rastin e kontrollit tek i njëjti, polici shtatshkurtër, pa flokë (*të cilit i referohet si polici i parë*), ia ka kërkuar dokumentet dhe ka konstatuar se nuk posedon të gjitha dokumentet e nevojshme për qarkullim, ndërsa gjatë kontrollit të veturës, polici më i gjatë të cilin e përshkruan dhe e identifikon në sallë të gjyqimit si të akuzuar V. G. (*i referohet herë polici i dytë, herë polici tjetër*), nën ulësen e shoferit i ka gjetur një sasi të vogël mariuhane, meqë në atë kohë dëshmitari thotë se ka konsumuar marihuanë, andaj i kanë kërkuar 300 euro, duke i thënë siç thotë dëshmitari “mos me u bë më e madhe, me shpëtu për shpejtësi dhe për marihuanë”. Me rastin e ndaljes, fillimisht i ka ardhur vetëm një polic, e kur ia kishte marrur dokumentet ka ardhur edhe polici tjetër, në momentin kur ka ardhur polici tjetër, dëshmitari thotë se ka dalë nga vetura, polici pa flokë i është drejtuar dhe ia ka kërkuar dokumentat, ndërsa polici tjetër ka qenë në afërsi të veturës mbrapa shpinës së dëshmitarit. Polici i dytë V. G., nuk ka ndërhyrë gjatë gjithë bisedës që dëshmitari e ka pasur me policin e parë. Më tutje dëshmitari ka shtuar se, pamja ka qenë e qartë dhe se në momentin kur polici i parë ia ka kërkuar paratë, distanca në mes policit të parë dhe të dytë ka qenë rreth dy metra dhe se bisedën e zhvilluar në mes dëshmitarit dhe policit të parë e ka dëgjuar edhe polici i dytë. Më tutje dëshmitari ka shtuar se, meqë nuk i ka pasur 300 euro me vete, në momentin kur është ndaluar nga policia, atyre u ka thënë se, më vonë do t’ua sjellë parat, kanë lënë vendin e takimit afërsisht aty pranë, dëshmitari posa është larguar ka kontaktuar përmes telefonit me dajën e tij, të cilit i ka kërkuar hua shumë prej 300 euro, ndërsa nga ai ka pranuar 100 euro dhe, bashkë me dajën kanë shkuar te gazetarët tek të cilët kishin lajmëruar rastin dhe ata ishin duke i pritur në hyrje të Fushë Kosovës. Pas shpjegimit të rastit nga ankuesi, me pëlqimin e tij, gazetarët kanë bërë incizimin e parasë dhe kanë marrur shifrat e bankënotës së 100 eurove, pastaj dëshmitari ka shkuar të takohet me policët në vendin ku e kishin lënë për takim, mirëpo për shkak se është errësuar nuk ka arritur të takohet me të njëjtit në atë vend, ka vazhduar të vozis në drejtim të Komoranit dhe në mbikalim kanë qenë policët të cilët kanë ardhë mbas tij dhe janë ndaluar pas veturës së dëshmitarit, atëherë dëshmitari ka dalë nga vetura, është drejtuar tek vetura e policisë me ia dhanë paratë, kah shoferi i veturës së policisë, i cili ishte polici siç thotë “qel-pa flokë”, polici që ia ka kërku paratë, të cilit edhe ia ka dorëzuar paratë, në shumë prej 140 euro dhe, i njëjti i është drejtuar me fjalët “merri dokumentat kurse drogën nuk po ta japim”, ndërsa policin e dytë e ka parë se ishte i ulur në veturë por me të nuk ka pasur asnjë lloj komunikimi. Në fund të deklaratimit, në cilësi të të dëmtuarit, i njëjti nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

Nga dëshmia e dëshmitarve A. S. dhe K. G., konstatohet se për rastin janë njoftuar nga një familjar i të dëmtuarit F. H., me të njëjtin janë pajtuar që të takohen në Fushë Kosovë, ku do të të takoheshim edhe me F., të cilin nuk e kanë njohur asnjëherë më parë, i njëjti në momentin e takimit, ua ka shpjeguar rastin e ndodhur. Më tutje të dy, njëjtë shpjegojnë se e kanë incizuar deklaratën e ankuesit me paratë në dorë, që ka qenë një banknotë në shumë 100 euro, kanë theksuar se me rastin e intervistimit, ankuesi iu ka pohuar se një pjesë të dokumentacionit ia kanë ndalë policët në vendin e ngjarjes, i njëjti me veturën e vet është largu nga vendi i ndaljes, për të shkuar me i marë paratë të cilat policët ia kishin kërkuar dhe që ankuesi nuk i kishte me vete. Më tutje kanë shtuar se tek udhëkryqi i Vragolisë, kanë parë se aty kanë qenë dy policë brenda në veturë të ndalur civile të policisë, mirëpo kanë pohuar se me syrin e lirë nuk kanë mund me i identifikuar personat brenda veturës së policisë, por as me syrin e kamerës nuk kanë arritë me identifikuar personat në brendinë e veturës së policisë, por i kanë parë si dy silueta, se personat brenda veturës kanë qenë me uniformë të policisë, shoferi gjithsesi, po ashtu nuk kanë arritur me pa e as me incizuar momentin e dorëzimit të parave. Të dy dëshmitarët pohojnë se tek Stacioni i Policisë Jugu në Prishtinë kishin parë duke zbritur nga vetura e njëjtë e policisë dhe duke hyrë në stacion, vetëm policin H. K..

I akuzuari V. G. në seancën e shqyrtimit shqyësor ka deklaruar se është e vërtetë se me datë 18.06.2012, bashkë me kolegun e tij, të bashkakuzuarin H. K.n, kanë qenë në detyrë prej orës 15:00 deri në ora 23:00, në drejtimin e caktuar Prishtinë-Drenas, me automjetin e policisë me targa civile, se gjatë patrullimit rreth orës 16:00, duke lëvizur në fshatin Sllatinë, e kanë vërejtur një veturë që lëvizte me shpejtësi më të madhe në zonën ku shpejtësia e kufizuar ishte 60 km/h, e kanë shenjëzuar për ndalim, i njëjti është ndal, ai bashkë me kolegun H. kanë dal prej veturës së policisë, H. ka bisedu me shoferin, ia ka shiqu dokumentet dhe është drejtuar kah i akuzuari V. i cili qëndronte prapa veturës në këndin e djathtë, duke bërë sigurimin e veturës. H. i është drejtuar V. me fjalët “nuk e paska sigurimin dhe librezën e veturës me veti”, ia ka thënë edhe fjalët e shoferit “ a bon mem lëshu se dokumentat i kam në shtëpi e do ti sjelli më vonë”, për çka i akuzuari V. i është përgjigjur “është rast i yti dhe ti e din a me lëshu a me ndal, unë në këtë rast jam polic sigurues”. H. me dokumente në dorë prapë është kthyer te shoferi, V. e ka parë që ka bisedu me shoferin, por bisedën e tyre nuk e ka dëgjuar, për shkak se ishte prapa veturës dhe për shkak të zhurmës së krijuar nga frekuentimi i veturave në rrugë dhe, për shkak se distanca midis tyre ka qenë afërsisht 4-6 metra. Ndërsa, kur e ka pyetur “a e lshove a çka bane”, H. i është përgjigjur “ia nala disa dokumenta”, si duket letërnjoftimin e prindit edhe patentën, kurse për konfiskim të diçkaje tjetër nuk i kishte thënë, pastaj H. ka vazhduar duke i thënë “i thash pasagjerit, do të jemi në këtë magjistrale në Sllatinë, nëse i sjell dokumentet deri në ora 20:00, jemi këtu, nëse jo atëherë vjen në stacionin Trafiku në Fushë Kosovë”. I akuzuari V. në vazhdim ka theksuar se, rreth orës 20:00, gjatë lëvizjes me automjet, H. e ka vërejtur veturën e njëjtë të cilën e kishin ndaluar në orën 16:00, se i kanë dhënë shenjë mu ndalë, ndërsa H. i ka thënë të shiqoj a mi ka sjell dokumentat dhe po kthehna, ka dal dhe pas afërsisht 30 sekondave është kthyer në veturë të policisë, pas tij ka ardhur edhe shoferi i asaj veture, ndërsa vet i akuzuari V. ka qenë në ulësen e pasagjerit duke përfunduar raportin me skicë të aksidentit të komunikacionit (me tri vetura), ndërsa ka ndëgju zanin e shoferit duke i thanë H. (i ulur në ulësen e shoferit), “që t'i solla

dokumentat që m'i kërkove më herët", por se çka ka biseduar H. me shoferin më parë, kur ai doli prej veturës së policisë gjatë atyre 30 sekondave, këtë nuk e din sepse nuk ka mundur ta degjojë. Më tutje ka shtuar se pas përfundimit të ndërrimit, H. e kishte dërguar V. në shtëpi të tij, kurse pas 20 minutash e kishte thirrë shefi i operativës, pohon se pas ngjarjes i akuzuari e kishte pyetur kolegun H. se kah të erdhën këto 100 euro në xhep, si ndodhi kjo punë, i njëjti i kishte thënë "i kam gjetë të paluara afër ulëses së shoferit në anën e majtë, kur e kam pastru veturën", sepse ata zakonisht e kanë obligim me i largu mbeturinat nga vetura, kurdo që e përfundojnë ndërrimin.

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit të paraqitur në formë të shkruar, të elaboruar gojarisht, ka theksuar se, nga deshmia e dëshmitarëve F. H., K. G. dhe A. S., si dhe nga provat tjera materiale, është vertetuar se i akuzuari V. G. ka kryer veprën penale që i vihet nëbarrë dhe se është penalisht përgjegjës. Më tutje ka shtuar se nga orani ditor i datës 18.6.2012 vertetohet se dy të akuzuarit kanë qenë në detyrë, në ndërrimin e pasdites, prej ora 15:00 deri ne ora 23:00 me automjetin zyrtar *numri i targave...*, e që vertetohet nga raporti i nënshkruar i pranimit drëzimit të automjetit zyrtar në ditën kritike me datë 18.06.2012, në emër të ekipit "D". Fakti se të akuzuarit kanë vepruar në bashkëkryerje vertetohet nga deshmia e të dëmtuarit të dhënë në cilësinë e dëshmitarit, i cili ka pohuar se me datë 18.06.2012 rreth orës 15:00 ka qenë duke drejtuar veturën e markës "Shkoda Oktavia" me targa daneze, në relacionin Fushë Kosovë-Komoran, afër pikës së karburanteve "A. B." kur është ndalur nga policia në fshatin Sllatinë. Posa policet kanë vërejtur mungesën e policës së sigurimit në dokumentacionin e kontrolluar dhe pasi që kanë gjetur kesen e fshehur me 2 gram kanabis, i janë drejtuar duke i thënë se duhet të lajmëohet ne Ambasaden e Danimarkës, polici më në moshë i ka thënë se duhet t'i sjellësh 300 euro për të shpëtuar nga ky problem dhe se në atë moment prezent kanë qenë dy policët, "polici pa flokë më është drejtuar dhe më ka kërkuar dokumentat", ndërsa polici tjetër ka qenë në afërsi të veturës mbrapa shpinës së tij, duke shtuar se në distancën në të cilën ka qenë polici i dytë, ka mundur të degjojë bisedën dhe se polici në moshë më të re më ka thënë, "nëse e merr vesh dikush tjetër përveç neve, po tregove për këtë rast unë të vras ty". Më tutje ka vazhduar duke theksuar se bashkryerja veretohet edhe nga rrethana e dorëzimit të të hollave, në të cilën prezent kanë qenë bashkë të akuzuarit, edhe pse i akuzuari V. G. ka qëndruar në heshtje, përsëri i njëjti ka dëgjuar bisedën në mes të dëmtuarit dhe të bashkëakuzuarit H. K.. Po ashtu është vërtetuar se kartmonedha në vlerë prej 100 euro të cilën i dëmtuari ia kishte dorëzuar të akuzuarit H. K., është gjetur tek i njëjti gjatë kontrollit të tij në Stacionin Policor Jugu në Prishtinë, çka e hedhë poshtë mbrojtjen e të akuzuarit V. G., se kinse H. i ka thënë se i ka gjetur te paluara afër ulëses së shoferit në anën e majtë kur kishte pastruar automjetin zyrtar. Poashtu janë të pambeshtetshme pretendimet e të akuzuarit se ai nuk ka dëgjuar çka ka biseduar bashkë i akuzuari H. K. dhe se ai nuk e ka ditur qëllimin e takimit të dytë me të dëmtuarin, pasi që si në rasin e parë edhe në rastin e dytë i akuzuari V. G. ka qëndruar pranë kolegut të vet dhe të dëmtuarit në atë distancë, prej së cilës lëhtësisht ka mund të dëgjoj komunikimin verbal në mes tyre, pa qenë i penguar nga zhurma e makinave siç pretendon i akuzuari. Bazuar në të theksuarat e sipërshënuara, prokurori i shtetit konstatoi se është vertetuar se i akuzuari V. G. është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet, andaj i njëjti duhet të dënohet dhe me rasin e matjes së dënimit të njëjtit t'i shqiptohet dënimi që është në përputhje me përgjegjesin e tij penale dhe rrezikshmerinë e veprës penale, duke marrë si rrethë rënduese

kohezgjatjen e përvojës së punës dhe shperblimin me medalijen e besnkërisë, profesnializmit, etikës së pastër dhe përkushtimit, që janë në kundërshtim të plotë me veprën penale të kryer nga ana e të akuzuarit V. G..

Në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarit V. G., av.G. H., gjithashtu ka prezantuar fjalën përfundimtare në formë të shkruar dhe të njëjtën e ka elaboruar gojarisht, duke theksuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij V. G., ka kryer veprën penale marrje rrushfeti nga neni 343 par 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Me tutje ka shtuar se është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit F. H. se këtë vepër e ka kryer H. K. i cili ia ka kërkuar parat prej tij dhe se po ashtu siq ka pohuar dëshmitari ja ka dorëzuar të njëjtit, fakt që vërtetohet se parat janë gjetur te i akuzuari H. K., para këto në shumë prej 100 euro, e që paraprakisht janë fotografuar nga ekipi i emisionit Drejtësia në Kosovë dhe se, i mbrojturi i tij nuk ka qenë prezent me rastin e pranimit të parave dhe nuk ka dëgjuar bisedën që është zhvilluar në mes tyre. Më tutje ka shtuar se edhe nga deklarata e të mbrojturit të tij V. G., është vërtetuar se ai nuk ka kërkuar para nga i dëmtuari, se parat nuk janë gjetur tek ai, se i njëjti asnjëherë nuk ka qenë kryes i ndonjë veprë penale të kësaj natyre apo të ngjajshme, se nuk ka pasur asnjëherë vërejtje në punë të tij dhe se i njëjti është shperblyer me mirënjohje në 10 vjetorin e punës, si pjestar i Policisë së Kosovës. Në këto kushte ka kërkuar që për të mbrojturin e tij, të merret aktgjykim lirues meqenëse nuk është vërtetuar se i njëjti është kryes i veprës penale për të cilën është i akuzuar.

Ne këtë qështje penale, nuk ishte kontestues fakti se të bashkë akuzuarit, kolegët V. G. dhe H. K. i cili gjendet në arrati, me datë dhe kohë sipas akuzës, kanë qenë në detyrë zyrtare, meqë ky fakt vërtetohet edhe nga prova - orari zyrtar i ndërrimit i datës 18.06.2012, pra, të njëjtit kanë qenë në ndërrimin e pasdites nga ora 15:00-23:00 dhe se ne posedim kanë pasur veturën zyrtare me targa regjistrim *numri i targave...*, po ashtu nuk është kontestues as fakti se të njëjtit si policë të trafikut, gjatë orarit zyrtar, kishin ndalur veturën “Shkoda Octavia” me targa të huaja daneze, për tejkallim shpejtësie, të cilën veturë e drejtonte i dëmtuari F. H., e i cili nuk kishte poseduar dokumentet e kompletuara për lëvizje me veturë, fakte këto të cilat as i akuzuari V. nuk i konteston. Mirëpo kontestues është fakti nëse i akuzuari V. bashkë me kolegun e tij H. janë pajtuar që në shkëmbim të mos shqiptimit të fletëparaqitjes për kundërvajtje të shkaktuar në komunikacion, t’ia kërkojnë shumë prej 300 euro, duke u pajtuar njëherësh edhe për vendin dhe kohën e dorëzimit të shumës së parave të kërkuara dhe, nëse të njëjtit ishin bashkë dhe në dijeni për marrjen e rryshfetit në shumë prej 100 euro, nga i dëmtuari F. H., përkatësisht nëse i akuzuari V. kishte kontribuar në kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar si bashkëkryes.

Provës për orarin ditor të partollave, gjykata i afali besimin, meqë ishte zyrtar dhe nuk u kontestua fare. Gjykata gjithashtu ia fali besimin edhe Videoincizimit në CD të bërë nga dëshmitarët, e që janë gazetarë hulumtues të BIRN –it, të cilëve i dëmtuari F. u rrefen se si dy policë e kanë ndalur gjatë vozitjes, dhe ia kanë ndalë dokumentet për të mos i shqiptuar kundërvajtjen në komunikacion, i kanë kërkuar shumë prej 300 euro, se janë pajtuar që të takohen te “ura për në Dobrevë” në ora 20:00. Pastaj vazhdon rrëfimin se policëve do ua dorëzojë shumë prej 100 eurove, banknotë të cilën e mban në dorë dhe në të cilën vërehet numri serik S23754944905. Po

ashtu në të njëjtin videoincizim shfaqet vetura zyrtare me targa *numri i targave...*, e cila gjendet afër vendit ku siç e përshkruan i dëmtuari, është pajtuar që të njëjtëve t'ua dorëzoj shumën e parave prej 300 euro. Ndërsa nga fotokopja e bashkangjitur në shkresa të lëndës e bankënotës në vlerë prej 100 euro, evidentohet numri serik S23754905, para kjo me numër serik të njëjtë e cila është gjendur ne protofolin e të akuzuarit H. K. në lokalet e Stsaconit policor Jugu në Prishtinë. Rrjedhimisht, këto janë prova materiale të besueshme të cilave gjykata ia fali besimin në tërësi.

Gjykata poashtu ia fali besimin dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit F. H., meqë i njëjti u deklarua në mënyrë të sinqertë, dëshmia e tij ishte në përputhje të plotë me provat tjera materiale si dhe me dëshmitë e dëshmitarëve A. S. dhe K. G., të cilët në kryerjen e detyrës së tyre si gazetarë hulumtues, duke mos cënuar në asnjë moment kodin etikës së punës së tyre, me të vetmin qëllim që të dëshmojnë një realitet të hidhur në Kosovë, për hir të drejtisë, kanë dëshmuar me sinqeritet në këtë proces gjyqsor, andaj gjykata gjithsesi ua fali besimin e plotë.

Bazuar në provat e lartshënuara, të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari V. G. duke vepruar në cilësi të personit zyrtar, me qëllim të përfitimit për vete në bashkveprim me kolegun e tij H. K., ka pranuar nga drejtuesi i veturës së ndalur shumën e parave në vlerë prej 100 euro, ne shkëmbim të mos shqiptimit të fletëpaqraitjes për kundërvajtje, për shkak të tejkalimit të shpejtesis dhe mungesës së dokumentacionit të nevojshëm për levizje me veturë, veprime këto të kryera me dashje dhe me vetëdije të plotë.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit V. G., të cilit nuk ia fali besimin, meqë i njëjti është munduar të ik nga përgjegjësia penale me pretendimin se nuk e ka dëgjuar bisedën midis kolegut të tij H. dhe shoferit të veturës që e kishin ndalur, as në momentin e parë kur ia kanë kërkuar dokumentet, e as në momentin e dytë kur shoferi ia ka dorëzuar paratë kolegut të tij H.. I njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur me pretendimin se “H. me dokumente është kthyer prap te shoferi, e kam parë që ka bisedu me të, por nuk e di çka ka bisedu, unë bisedën nuk e kam dëgju fare, e ka lënë të shkojë”, etj, mirëpo gjykata këto deklarime të tij nuk i gjenë të bazuara, pasi që, siç është pohuar nga shoferi i veturës, dëshmitari F. H., në momentin kur është zhvilluar biseda në mes tij dhe policit të parë, polici i dytë V. G., ka qenë në afërsi prapa shpinës së policit të parë, në distancë prej 2 metarsh, dhe ka dëgjuar bisedën e tyre, dhe kjo është e pranueshme, sepse ka qenë e pamundshme që i njëjti të mos dëgjojë përmbajtjen e bisedës së zhvilluar. Po ashtu pretendimi i të akuzuarit se kur janë takuar me të dëmtuarin për herë të dytë, nuk ka dëgjuar bisedën në mes kolegut të tij dhe të dëmtuarit me përjashtim të fjalisë “qe ti solla dokumentat që m’i kërkove më herët”, është kontradiktore me vetë përshkrimin e situatës në momentin e pikërishtëm. I akuzuari e përshkruan situatën kështu “H. më tha të shiqoj a mi ka sjell dokumentat dhe po kthena, ka dal dhe pas afërsisht 30 sekondave është kthyer në veturë të policisë, ka ardhur edhe shoferi i asaj veture, unë në ulësen e pasagjerit isha duke përfunduar raportin me skicë të aksidentit të komunikacionit (me tri vetura), e kam ndëgju zanin e shoferit duke i thanë H. (i ulur në ulësen e shoferit), qe t’i solla dokumentat që m’i kërkove më herët, se çka ka biseduar H.me shoferin më parë, kur doli prej veturës gjatë atyre 30 sekondave, unë nuk e di”. I akuzuari pretendon se kolegu i tij H. ka dalur nga vetura dhe pas afërsisht 30 sekondave është kthyer në

veturë të policisë, dhe se çka ka biseduar H. me shoferin kur ka dalë prej veturës së policisë gjatë atyre 30 sekondave nuk e ka ditur, ndërsa më pas pohon se i dëmtuari ka ardhur në drejtim të automjetit dhe i është drejtuar H. “ti solla dokumentet që mi kërkove me herët”, rrjedhimisht kjo fjali tregon se më parë në mes të dëmtuarit-dëshmitarit dhe të akuzuarit H. K. në momentin e pikerishem nuk është zhvilluar bisedë siq pretendon i akuzuari V. dhe se i akuzuari H. K. nuk ka dalë fare nga vetuara siq pretendon i njëjti, por siç e ka pohuar dëshmitari F. H., polici i parë ka qëndruar në veturë të policisë, i ulur në momentin kur i dëmtuari ia ka dorëzuar paratë dhe, për rrjedhojë i akuzuari V. G. ka dëgjuar bisedën ndërmjet tyre dhe ka parë gjithë atë çfarë është zhvilluar në atë moment. Nga dëshmitari F. është pohuar se në momentin kur i ka dhënë paratë, vetura e policisë nuk ka qenë e ndriçume dhe për rrjedhojë nuk ka mundur ta shohë personin e dytë në veturë, përveç që ka vrejtur pranin e tij, mirëpo vetë i akuzuari i V. G. e ka pranuar se ka qenë ulur në ulësen e parë të veturës, ndërsa në ulsen e shoferit ka qenë i ulur kolegu i tij, i akuzuari H. K.. Gjykata në shkresat e lëndës gjithashtu gjeti edhe konstatimin e oficerit policor N. D., të datës 25.06.2016, sipas të cilit, i njëjti e kishte dëgjaur policin H. duke u përgjigjur telefonatës së policit V. G., me fjalët “hajde në stacion se na kanë fotografuar”. Rrjedhimisht, gjykata nuk ia falë besimin as pjesës së deklaramit të t’akuzuarit V. kur thotë se kinse e ka pyetur kolegun H. kah të erdhën këto 100 euro, përderisa i njëjti paraprakisht veq ka qenë në dijeni.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit, av. G. H. se nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij është involvuar në kryerjen e kësaj veprë penale dhe se paratë janë gjetur tek i bashkë akuzuari H., të cilat siq është thënë nga i dëmtuari F., ia ka dhënë të bashkë akuzuarit H. dhe se bisedën në mes të njëjtit dhe të dëmtuarit F., nuk e ka dëgjuar i mbrojturi i tij V. G.. Këto pretendime, gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara meqenëse sipas nenit 23 të KPK, bashkëkryerje konsiderohet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona, duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër. Pra, për t’u gjendur në kushtet e bashkëkryerjes duhet të bashkë ekzistojnë si kushte sine qua non: dy ose më shumë subjekte, dhe siq është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqsor dhe, është pranuar edhe nga vetë i akuzuari, ai gjatë gjithë kohës ka qenë me bashkë të akuzuarin H. K., edhe në momentin kur i dëmtuari është ndalur për herë të parë, ashtu edhe në takimin e dytë. Realizimi i faktit kriminal me gjithë elementet e tij materiale, tregon se është cënuar një marrëdhënie shoqërore e mbrojtur nga ligji penal, duke ardhur objektivist një pasojë kriminale nga veprimi ose mosveprimi shoqërisht i rrezikshëm, që në rastin konkret rezulton i provuar se, i akuzuari V. G., ka kryer veprën penale Marrje rryshfeti nga neni 343 par 2 lidhur me nenin 23 të KPK. Secili bashkëkryes, ka dhënë kontributin relevant në kryerjen e veprës penale, që në rastin konkret i akuzuari V. G. e ka shoqëruar të bashkë akuzuarin H. pavarësisht faktit që i njëjti nuk ka komunikuar me të dëmtuarin me rastin e dorëzimit të parave, prania e tij fizike në momentin e kërkimit të parave dhe në momentin e dorëzimit të tyre, nënkupton si të provuar faktin se i njëjti ka dëgjuar përmbajtjen e bisedave në dy momentet e referuara, d.m.th. ka qenë në dijeni se po veprohet në mënyrë të kundërligjshme, e kjo përbënë një kontribut thelbësor në kryerjen e kësaj veprë penale, shtuar këtu edhe natyrën e punës së tani të akuzuarit, që detyrimi për të qëndruar së bashku është obligim gjatë gjithë orarit të punës. Gjykata vlerëson se në mënyrë që të ndodhemi përpara institutit të bashkëkryerjes, karakteristikë është uniteti i anës subjektive të veprës penale të

kryer në bashkëkryerje, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëkryeresve në realizimin e veprës penale me veprimet apo mosveprimet e tij dhe pavarësisht përgjegjësisë penale që ai mban për këto veprime a mosveprime, përcaktimi i të cilave i takon rrethanave të faktit të provuar në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata, pas vlerësimit të rrethanave të tërësishme bazuar në faktet e provat e lartshënuara, konstatoi gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit V. G. janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale në bashkëkryerje Marrje rryshfeti nga neni 343 par 2 lidhur me nenin 23 të KPK dhe, pasi që më parë gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues duke qenë i vetëdijshëm se dënimi penal përfaqëson reagimin shtetëror ndaj subjekteve të gjetura fajtores për kryerjen e një vepre penale, pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që përcaktojnë llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarin, si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se gjykata nuk ka të dhëna se ndaj tij është duke u zhvilluar procedurë penale për vepër penale të njëjtë apo të ngjajshme, sjelljen korrekte të t'akuzuarit në gjykatë, gjendjen e tij familjare, se është i martuar dhe mbajtësi i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti obligimin e dyfishtë të të akuzuarit që, si person zyrtar të luftojë vepra të natyrës korruptive meqë paraprakisht ka qenë instruktor policie dhe është shpërblyer me medalje për shërbim me korrektësi, e jo të jetë pjesmarrës i drejtpërdrejtë i veprave të kësajnatyre, andaj gjykata ka peshuar këto rrethana dhe duke vepruar në interes të zbatimit të duhur të drejtsisë, të njëjtit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke synuar jo vetëm ndëshkimin por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprës penale në të ardhmen. Në këtë kuptim gjykata në pajtim me nenin 34 të KPK mbi qëllimin e dënimit, në shqiptimin e të njëjtit është udhëhequr jo vetem nga parimi i ligjshmeris dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmëris dhe individualizmit të tij, duke vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me kërkesën pasurore- juridike, gjykata nuk ka vendosur, pasi që i dëmtuari F. H. shprehimisht ka deklaruar se nuk dëshiron të parashtrojë kërkesë të tillë.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par 2 lidhur me 453 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.214/13, me datë 19.10.2016

Sekretarja juridike,

Ardita Azemi

Kryetarja e trupit gjykues,

Suzana Çerkini

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.